



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

---

**C.nr.1102/13**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, gjyqtari Lumni Sallauka, me procesmbajtësen Raxhije Emini, në kontestin e paditësit A. B., nga Prizreni, të cilin e përfaqëson av. N. Q., nga Prizreni, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari Shefqet Hasimi nga Prishtina, me objekt të padisë anulimin e vendimeve për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datë **05.03.2014**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET si e pabazuar**, kërkesëpadia e paditësit A. B., nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që “të anulohen vendimet e të paditurës - vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës P.nr.080/VDP/2009, i datës 04.12.2009 dhe vendimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme (pa numër), i datës 15.01.2010, si të kundërligjshme, të obligohet e paditura që paditësit A. B., t’ia paguaj – kompensoj të ardhurat personale në lartësi sipas kontratës së punës që nga data 04.12.2009, të obligohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës që paditësin ta kthej në vendin e njëjtë të punës, zyrtar policor në Policinë e Kosovës në Prizren, si dhe të obligohet e paditura që t’i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm”.

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi A. B. nga Prizreni me datë 07.10.2010, ka parashtruar padi në gjykatë, me të cilën ka kërkuar që të anulohen vendimet e të paditurës - vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës P.nr.080/VDP/2009, i datës 04.12.2009 dhe vendimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme (pa numër), i datës 15.01.2010, si të kundërligjshme, të obligohet e paditura që paditësin A. B., t’ia paguaj – kompensoj të ardhurat personale në lartësi sipas kontratës së punës që nga data 04.12.2009, të obligohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës që paditësin ta kthej në vendin e njëjtë të punës, zyrtar policor në Policinë e Kosovës në Prizren, si dhe të obligohet e paditura që t’i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

## 1. Juridiksioni i gjykatës

Fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kësaj çështjeje dhe bazuar në nenin 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), por edhe me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, më saktësisht nenit 79, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kjo gjykatë është kompetente për të vendosur këtë çështje.

Lidhur me kompetencën lëndore, në bazë nenin 17.2 të LPK-së: *“Vlerësimi i kompetencës bëhet në bazë të thënieve në padi dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura gjykata”*. Meqënëse ndodhemi përpara një kontesti me karakter civil që rrjedh nga marrëdhënia e punës, gjykata çmon se është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Lidhur me kompetencën territoriale në bazë të nenit 37.1 të LPK-së: *“Në qoftë se me ligj nuk është caktuar kompetenca ekskluzive territoriale e ndonjë gjykate tjetër, për procedimin e çështjes është kompetente gjykata e kompetencës së përgjithshme për palën e paditur”*. Duke qënë se vendi i punës së paditësit është në qytetin e Prizrenit, rezultoi se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështjeje civile është kjo gjykatë.

Pala paditëse, legjitimohet t’i drejtohet gjykatës me këtë padi pasi pretendon se i janë shkelur të drejtat nga marrëdhënia e punës, dhe kërkon të rivendosë në vend këto të drejta. Ndërsa pala e paditur ka legjitimacion real pasiv në këtë çështje juridike kontestimore, pasi që i njëjti ja ka ndërprerë marrëdhënien e punës paditësit.

Gjithashtu gjykata, në vështrim të nenit 67 të LPK-së, çmoi se nuk ekzistojnë për të shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pa kundërshtuar dhe nga palët prezent në gjykim.

## 2. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

I autorizuari i paditësit av. N. Q., në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe në precizimin e kërkesëpadiës së parashtruar me dt.14.02.2014. Sipas provave që janë propozuar në padi do të vërtetohet baza juridike e kërkesës dhe nga vërtetimi i gjendjes faktike do të vërtetohet se vendimet e të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës janë në kundërshtim si me ligjin e punës ashtu edhe me ligjin për Policinë e Kosovës, pasi që në asnjë rast dhe me asnjë dispozitë nuk është përcaktuar se shpallja fajtor i një të punësuarit për vepër penale e cila nuk ka dënim me burg dhe nuk ka të bëjë me detyrat e punës, paraqet shkelje të rënda të detyrave të punës, në këtë aspekt konsideroj se vendimet e të paditurës janë të paligjshme. E sa i përket pikës III të kërkesëpadiës, konsideroj se e drejta në kompensim në të ardhurat personale në lartësi sipas kontratës së punës, është e drejtë në dispozitat ligjore në rast se punëtorit i shkëputet marrëdhënia e punës pa të drejtë, edhe pika e IV e kërkesëpadiës është një e drejtë ligjore që buron nga kontrata e punës dhe nga dispozitat ligjore të Ligjit të punës, të cilat përcaktojnë se në rast të anulimit të vendimit për ahkëputjen e kontratës së punës, institucioni ku ka punuar punëtori ka për obligim që të njëjtin ta kthej në punë. Po ashtu në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në këtë çështje kontestimore, të iniciuar nga paditësi me padi, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurës për shkëputjen e kontratës dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës, janë administruar provat e propozuara nga palët nga të cilat kanë vërtetuar gjendjen faktike (më gjerësisht si në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim), ku në fund të fjalës përfundimtare ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e

paditësit ta aprovoj të bazuar, të anulojë vendimet e sulmuara, punëtorin ta kthej në vendin e punës, të i kompensojë të ardhurat personale sipas kontratës së punës që nga shkëputja e kontratës deri në kthimin e punëtorit në punë, tia njuh të gjitha të drejtat nga vendi i punës. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë 90 euro në emër të përpilimit të padisë, për dy përfaqësime dhe përpilimin e padisë në shumën prej 248 euro, gjithsej shumën prej 348 euro.

I autorizuari i të paditurës Shefqet Halimi, në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes së dhënë në padi, pranë parashtrimeve në seancat e mbajtura, duke i propozuar gjykatës që ta refuzon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Kjo me arsyetim se Organi punëdhënës i ka kryer të gjitha procedurat e iniciuara, i njëjti ka pasur vërejtje gojore edhe me herët për shkelje të doracakut dhe parimet nga marrëdhënia e punës. Tek paditësi nuk ka ndikuar pozitivisht kjo vërejtje gojore, i njëjti i ka përsëritur të njëjtat shkelje edhe disa herë të tjera, kështu që me dr.29.07.2008, është iniciuar procedurë nga Prokuroria lidhur me shkaktimin e lëndimeve të lehta personit E. H., kështu që gjykata me Aktgjykim e ka dënuar me burg në kohëzgjatje prej 6 muajve i cili dënim është i plotfuqishëm, kjo vërteton se paditësi ka ushtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë respektivisht ka përdorur mjetet e jashtëzakonshme. Organi i punësimit gjegjësisht Inspektorati Policor sipas detyrës zyrtare kanë iniciuar procedurën e brendshme disiplinore, lidhur me shkeljet të cilat organi i ka konsideruar shkelje të rënda, bazuar në Ligjin për Policinë e Kosovës, Inspektoratit të Kosovës, Doracakun e përgjithshme të parimeve të policisë dhe ka nxjerr vendim të bazuar në procedurë administrative, i lëshuar dhe i vulosur nga Ministri i Punëve të Brendshme me dt.15.01.2010, që e ka lënë në fuqi vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe rekomandimin e KELD-it, me vendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Sipas shkresave të lëndës me dt.20.07.2008 është suspenduar me pagesë dhe kjo pagesë ka vazhduar deri më 31.12.2009. Gjykatës i propozoj që pas shtjellimit të provave të propozuara të refuzon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, ngase duke marrë parasysh edhe atë se polici edhe kur nuk është në orar të punës respektivisht në detyrë ai duhet të sillet sikur është në detyrë sepse çdo sjellje e tij jashtë orarit të punës reflekton negativisht në marrëdhënien e punës. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se Paditësi ka dështuar që ti ofrojë prova të besueshme se padia dhe kërkesëpadia është e bazuar, nga ana tjetër e paditura ka ofruar prova të pakontestueshme që padinë dhe kërkesëpadinë ta refuzon si të pabazuar nga fakti se me dt.29.05.2004 kundër paditësit është iniciuar akuza për shkelje të Doracakut të parimeve dhe Procedurave të ShPK-së sipas parimit P.1.1.16 IIIB që me dt.20.02.2006 është bërë degradimi e aprovuar nga R. W. Zëvënës Komisar i Administratës për akuzat shkelje e Kodit të Etikës Policore, Sjellje private/Qëndrim ndaj profesionit, Standard i sjelljes, Rregullat e sjelljes dhe kryerjes së detyrës, Bindja ndaj Ligjeve, marrëveshjeve dhe rregullave, Sjellja e pavend e Policit. Ende pa kaluar një kohë prej dt.20.02.2006 paditësi bënë shkelje edhe më të rënda që do të thotë se nuk ka ndikuar masa e shqiptuar ulja në gradë, kështu që me dt.23.08.2008, në Ortakoll i ka shkakuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarës E. H. për të cilën është dënuar me dënim me kusht prej 6 muaj. Vendimet dhe procedura e udhëhequr nga Organi punëdhënës është zhvilluar konform dispozitave ligjore dhe ka nxjerr vendim të drejtë Ndërprerja e marrëdhënies së punës. Paditësi për veprimet penale është dënuar me aktgjykim të formës së prerë, ndërsa sa i përket kthimit në punë nuk mund të ndodhë me arsye se Policët e tillë, R. Kosovës me sjellje të tilla nuk i duhen. Andaj gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet se e pabazuar. Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

### *3. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor*

Në këtë drejtim gjykata për vlerësimin e drejtë të kësaj çështje juridike, ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: leximin e vendimit të Ministrit të MPB-së të R. Kosovës, pa numër i dt.15.01.2010, leximin e vendimit të Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës P.nr.080/VDP/2009, leximin e shkresës së Policisë së Kosovës e dt.31.08.2004 me gjithë dokumentacionin përcjellës e një procedure disiplinore me një rast me herët, Shkresën e lëndës 20.02.2006, të Policisë së Kosovës me të gjithë dokumentacionin përcjellës lidhur me procedurën e zhvilluar në vitin 2006, leximin e deklaratës zyrtare me nr. NPB-IPK-1272/08, leximin e shkresës së dt.15.07.2008 KRH-02-075/2008, leximin e shkresës së dt.29.07.2008 nr.2008/329, leximin e aktgjykimit penal P.nr.742/08 të dt.01.09.2008, leximin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren AP.130/08 të dt.26.11.2008.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqës dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **e pa bazuar**.

#### *4. Faktet*

Me leximin e vendimit të Ministrit të MPB-së të R. Kosovës, pa numër i dt.15.01.2010, vërttohet fakti se me këtë vendim është hedhur poshtë si e pabazë ankesa e ushtruar nga A. B. këtu paditësi, zyrtar policor në Policinë e Kosovës, i punësuar në Nënstacionin Zhur-Regjioni i Prizrenit, me nr.2575, kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, me nr.080/VD/2009, të dt.04.12.2009, për shqiptimin e masës disiplinore Ndërprerja e Marrëdhënies së Punës, me arsyetim se ankuesi këtu paditësi A. gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ka kryer shkelje të rënda disiplinore e cila është e sanksionuar me dispozitat ligjore në fuqi.

Me leximin e vendimit të Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës P.nr.080/VDP/2009, gjykata ka konstatuar se Drejtori i përgjithshëm i Policisë ka marrë vendim për Ndërprerjen e marrëdhënies së Punës, këtu paditësit A. B., si zyrtar policor në Policinë e Kosovës, i punësuar në Nënstacionin Zhur-Regjioni i Prizrenit, me arsyetim se i njëjti ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor i paraparë me nenin 153 par.1 të KPPK. Për këtë çështje Gjykata Komunale në Prizren i ka shqiptuar paditësit dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 muajve me kusht. Kjo sipas vendimit të përmendur më lartë, bie në kundërshtim me Ligjin për Policinë e Kosovës, nenin 46, pika m) (veprimtari kriminale) dhe Udhëzimit Administrativ nr.15/2008-MPB neni 17 (veprimtari penale).

Me leximin e shkresës së Policisë së Kosovës e dt.31.08.2004, me gjithë dokumentacionin përcjellës e një procedure disiplinore me një rast me herët, gjykata ka konstatuar se këtu paditësit A. B., pas hetimeve të kryera ndaj tij, ka marrë masën disiplinore vërejtje me shkrim.

Me leximin në shkresën e lëndës 20.02.2006, të Policisë së Kosovës me të gjithë dokumentacionin përcjellës lidhur me procedurën e zhvilluar në vitin 2006, gjykata ka konstatuar se këtu paditësi A. B. është akuzuar për shkeljen e parimeve dhe procedurave të SHPK-së, dhe është suspenduar nga puna në kohëzgjatje prej 60 ditësh dhe degradim.

Me leximin e deklaratës zyrtare me nr. MPB-IPK-1272/08, gjykata ka konstatuar se Inspektoriati Policor i Kosovës me dt.23.07.2008, nga Drejtoria Rajonale e Policisë në Prizren e ka pranuar lëndën inicim i procedurës disiplinore ndaj Policit A. B. ID..., Polic në nënstacionin policor Zhur Regjioni i Prizrenit, ku në bazë të shqyrtimit të shkresave të lëndës ka filluar hetimet disiplinore nën dyshimin për shkelje disiplinore “Kanosje dhe Ndërhyrje në procesin e zhvillimit të hetimeve, në përputhje me Ligjin për Policinë neni 46 pika (m) dhe udhëzimi administrativ neni 17. Me shqyrtimin e shkresave lidhur me rastin që i njëjti ka pasur me ankuesen E. H. si dhe me tentimin e ndërhyrjes në procesin e hetimeve Inspektoriati Policor i Kosovës ka dhenë mendim se Polici A. B. ka kryer shkelje disiplinore “Kanosje dhe Ndërhyrje në procesin e zhvillimit të hetimeve” të parapara me Ligjin për Policinë neni 46 pika (m) dhe udhëzimi administrativ neni 17, dhe i ka propozuar Këshillit për emërime të Larta dhe Disiplinë Policore që pas shqyrtimit të provave të mbledhura nga Departamenti i hetimeve të IPK-së dhe duke u bazuar në dosjen e mëhershme disiplinore ndaj të dyshuarit, të vërtetoj përgjegjësinë dhe fajësinë e oficerit në fjalë duke i rekomanduar masën disiplinore Suspendim pa pagesë deri në 60 ditë (Ligji për Policinë neni 48, pika d.).

Me leximin e shkresës së dt.15.07.2008 KRH-02-075/2008, të kapiten S. J., nga Njësiti i Hetimeve Rajonale, gjykata ka konstatuar se këtu paditësit ka reaguuar për shkak të hetimit ndaj tij, i cili ishte duke u hetuar nga NHR Komanda në Prizren. Më tutje në këtë shkresë konstatohet se polici A. B., në objektin e KRP Prizren takohet me Kapiten S. J. dhe fillon ti shpjegoj problemin që ka me ankuesen. Të njëjtit i tërhiqet vërejtja se nuk do të diskutoj asgjë lidhur me problemin dhe se i njëjti do të paraqitet në Zyrë vetëm kur të ftohet zyrtarisht. Një ditë më vonë i njëjti prapë e thërret në telefon dhe interesohet se pse ishte sjellur në atë mënyrë me të një ditë më parë. Kapiten S. J. prapë i tërheq vërejtjen se i njëjti të mos thërret në hetime rajonale dhe as që të mos kontakton me askënd derisa të përfundon hetimi i rastit, përndryshe veprimet e tija do të konsiderohen si ndërhyrje në hetime. Pas kësaj i njëjti e ka kontaktuar edhe Togër J. K., ku është interesuar për rastin edhe pse disa herë i është tërheq vërejtja që të mos ndërhyrë dhe të kontakton askënd nga njësiti i hetimeve. Sipas këtij dokumenti këtu paditësi është interesuar se pse ende nuk janë ftuar dëshmitarët për intervistim, çka sipas policisë ka lënë të kuptohet se i njëjti ka kontaktuar me dëshmitarët gjatë procedurës.

Me leximin e shkresës së dt.29.07.2008 nr.2008/329, të nënkolonel M. K., gjykatës i rezultoi se këtu paditësi A. B., kishte telefonuar në nr. 0..-...-..., me Nënkolonelin K. dhe menjëherë ka filluar të kërcënohet duke i thënë “Baci Mus, tash kam me shku në shtëpi me e marr revolen dhe kam me ardhë me i vra ata të Krushës duke aluduar në të afërmit e ankueses-viktimës E. H. të cilët kanë qenë para Objektit të Komandës Rajonale, dhe e cila ka qenë në zyret e Hetimeve Rajonale, duke dhenë intervistë pikërisht për shqetësimet dhe kërcënimet që ia ka bërë këtu paditësi A. B. dhe për të cilën është hapur rasti.

Me leximin e aktgjykimit penal P.nr.742/08 të dt.01.09.2008, këtu paditësi A. B. është shpallur fajtor për veprën penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 153 par.1 të KPPK-së dhe gjykata i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve me kusht, i cili nuk do të ekzekutohet po që se i njëjti në afatin e verifikimit prej një viti nuk kryen vepër të re penale.

Me leximin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren AP.130/08 të dt.26.11.2008, gjykata ka konstatuar se paditësit i është refuzuar ankesa si e pabazë e ushtruar kundër aktgjykimit P.nr.742/08 të dt.01.09.2008, të Gjykatës Komunale në Prizren, ndërsa i njëjti aktgjykim është vërtetuar.

## 5. Ligji i aplikueshëm

Ligji i Policisë së Kosovës (**Ligji Nr. 03/L-035**) që ka qenë në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës paditësit, në nenin 2 parag. 2 përcakton: *“Zyrtarët policorë ushtrojnë autorizimet e tyre dhe kryejnë detyrat në mënyrë të ligjshme, të bazuara në Kushtetutë, në ligjet e tjera në fuqi dhe në Kodin e Etikës të hartuar nga Policia e Republikës së Kosovës dhe të miratuar nga Ministria e Punëve të Brendshme”*. Më tutje neni 45.1 i këtij ligji thotë: *“Akuzat për shkelje të rënda disiplinore, ku përfshihet zyrtari policor ose ndonjë punëtor tjetër i Policisë, përveç pozitive të larta, do t’i hetojë Inspektorati Policor i Republikës së Kosovës në përputhje me procedurat e përshkruara në ligjin në fuqi dhe në aktet nënligjore”*, ndërsa paragrafi 2 i po këtij neni thotë: *“Inspektorati do t’i raportojë të gjeturat e veta te Komisioni për Emërime të Larta dhe Disiplinë në Polici i cili përcakton se a është kryer ndonjë veprë disiplinore dhe në rast se vepra disiplinore është kryer, duhet t’i rekomandojë Drejtorit të Përgjithshëm masat disiplinore që duhen të ndërmerren”*. Më tutje parag. 3 i nenit 45 thotë: *“Drejtori i Përgjithshëm shqipton masën disiplinore, duke i marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit”*, ndërsa parag. 4 i këtij neni thotë: *“Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm mund të bëhet ankesë te Ministri. Vendimi i Ministrit do të jetë vendim përfundimtar administrativ dhe mund t’i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor vetëm nga gjykata kompetente”*. Neni 46 i ligjit të lartcekur përcakton shkeljet e rënda disiplinore, ku ndër të tjera në pikën m) si shkelje e rëndë përcaktohet veprimtaria penale, ndërsa neni 48 i këtij ligji përcakton masat disiplinore që shqiptohen në rast të shkeljeve të rënda disiplinore.

Kodi i Etikës së Policisë së Kosovës në nenin 3 ndër të tjera përcakton se: *“Detyrë e parë e policit si zbatues i ligjit është që të njohë kufijtë e shtrirjes së autorizimit të tij gjatë zbatimit të ligjit. Polici e përfaqëson vullnetin e lirë të një komuniteti, policët duhet të jenë të vetëdijshëm për kufizimet dhe ndalesat që komuniteti përmes aplikimit të ligjit ia ka besuar. Polici duhet të ketë të qartë se sistemi demokratik i qeverisë nuk i jep fuqi absolute veprimi asnjë personi, grupi njerëzish ose institucionit dhe duhet të kujdeset që si mbrojtës kryesor, i këtij sistemi, të mos lejojë askënd ta çoroditë karakterin e tyre”*. Më tutje neni 22 i këtij kodi ndër të tjera përcakton se: *“Masat disiplinore kundër personelit policor duhet t’i nënshtrohen shqyrtimit nga një organ i pavarur ose nga një gjykatë (masat e shqiptuara nga Standardet Profesionale duhet t’i nënshtrohen shqyrtimit nga Bordi i Ankesave i cili merr vendim, ndërsa në rastet e caktuara vendimi përfundimtar merret nga Komisari i Policisë)..”*

## 6. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të administruara, gjykata erdhi në përfundim se e paditura i ka respektuar në tërësi dispozitat ligjore në fuqi me rastin e ndërprerjes të marrëdhënies së punës paditësit. Fillimisht ndaj paditësit me datë 31.08.2004, janë inicuar procedura disiplinore për shkak shkeljeve të rregullave të sjelljes dhe kryerjes së detyrës, ku ndaj tij organi kompetent i policisë i ka shqiptuar masën disiplinore suspendim pa pagesë 60 ditë dhe ulje e gradës (vendimi përfundimtar është marr nga komisari i policisë me datë 20.02.2006) për shkak të shkeljeve të Doracakut të Parimeve dhe Procedurave të Shërbimit Policor të Kosovës, sipas parimit P.1.1.16.VIIIB. Më tutje ndaj paditësit sërish me datë 23.07.2008 nga Drejtoria Rajonale e Policisë së Kosovës në Prizren inicohet procedura e brendshme, për shkak se i njëjti kishte kryer veprë penale lëndim i lehtë trupor ndaj të

dëmtuarës E. H., ku sipas tyre i njëjti ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Policinë, Kodin e Etikës së Policisë së Kosovës. Veçmas procedurës disiplinore ndaj këtu paditësit zhvillohet procedura penale, ngritet aktakuza dhe pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor i njëjti nga Gjykata Komunale në Prizren shpallet fajtor për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 parag. 1 të KPPK-së dhe gjykohet me dënim me kusht në kohëzgjatje prej 6 muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i njëjti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ap.nr.130/08, datë 26.11.2008. Krahas zhvillimit të procedurës penale të përmendur më lartë, ndaj paditësit është zhvilluar procedura disiplinore për shkelje të detyrave të punës, e cila përfundon me vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë P.nr.080/VDP/2009, datë 04.12.2009, me të cilin paditësit i shqiptohet masa disiplinore ndërprerja e marrëdhënies së punës. Ky vendim konfirmohet edhe me vendimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 15.01.2010. Gjithashtu gjatë kohës së kryerjes së hetimeve penale ndaj paditësit, është konstatuar (në dokumentet policore) se i njëjti ka ndërmarr hapa të kundërligjshëm, duke u munduar që të ndërhyjë në zhvillimin e hetimeve, edhe përkundër faktit se të njëjtit i është tërhequr vërejtja për këtë gjë.

Nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, gjykata erdhi në përfundim se e paditura ka vepruar drejtë kur i ka shkëputur marrëdhënien e punës paditësit. Kjo për faktin se me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës paditësit, e paditura ka zbatuar në tërësi procedurën disiplinore të paraparë me Ligjin për Policinë e Kosovës (**Ligji Nr. 03/L-035**), nenet 2.2 dhe 45, si dhe ka zbatuar në tërësi dispozitat e Kodit të Etikës për Policinë e Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ nr. 15/2008, për llojet e shkeljeve të rënda dhe të lehta disiplinore në Policinë e Kosovës. Nga provat e elaboruara më lartë rezultoi se e paditura ka respektuar në tërësi nenin 45 të Ligjit të Policisë, i cili përcakton rrjedhjen e procedurës në rast të dyshimit se zyrtari policor ka bërë shkelje disiplinore. Në rastin e paditësit bazuar në parag. 1 të nenit 45, hetimet disiplinore i ka udhëhequr Inspektoriati Policor, i cili i ka rekomanduar Komisionit për Emërime të Larta dhe Disiplinë në Polici, që këtu paditësit t'i shqiptojë masën disiplinore suspendim pa pagesë deri në 60 ditë. Më tutje Komisioni i përmendur më lartë i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që paditësi të shpallet fajtor për shkelje disiplinore dhe ndaj tij të shqiptohet masa disiplinore ndërprerja e marrëdhënies së punës (neni 45.2). Në bazë të këtij rekomandimi Drejtori i Përgjithshëm i Policisë merr vendim me të cilin paditësit i shqiptohet masa disiplinore ndërprerja e marrëdhënies së punës, i cili vendim siç e cekëm edhe më lartë është vërtetuar edhe me vendimin e Ministrit të Punëve të Brendshme. Kjo do të thotë se e paditura ka respektuar në tërësi procedurën e paraparë disiplinore ndaj paditësit. Ndërsa pretendimet e palës paditëse se vendimi i Drejtorit të Policisë ka të meta formale, gjykata nuk i pranoi, pasi në këtë vendim vetëm është konsultuar se paditësi është shpallur fajtor në lidhje me rastin penal (nga Gjykata) për të cilin është dënuar, si dhe ndaj tij është shqiptuar masa disiplinore, bazuar në nenin 45 parag. 3 dhe nenit 46 të Policisë së Kosovës, nenit 34 parag. 6 të Ligjit për Inspektoriatin Policor dhe nenit 17 të udhëzimit administrativ nr. 15/2008, e jo siç ka pretenduar paditësi se është shpallur fajtor në procedurë disiplinore. Në këtë drejtim gjykatës i rezultoi se masa e shqiptuar disiplinore ndaj paditësit ka qenë adekuate me shkeljen e cila është paraparë me nenin 46 germa m), nenit 48 pika a) e Ligjit të Policisë dhe nenit 17 të Udhëzimit Administrativ. Nr. 15/2008. Kjo për faktin se neni 17 i Udhëzimit Administrativ të cekur më lartë shprehimisht thotë: *“Zyrtari policor dhe stafi civil i Kosovës është fajtor nëse për veprën penale apo kundërvajtjen e rëndë të cilën e ka kryer është shpallur fajtor dhe është dënuar sipas ligjit në fuqi nga cilado gjykatë, që njihet nga ligjet e Kosovës”,* gjë që në rastin konkret ka ndodhur me paditësin, pasi që i njëjti është shpallur fajtor për lëndim të lehtë trupor.

Edhe pretendimin tjetër të palës paditëse se e paditura nuk ka zhvilluar procedurë disiplinore ndaj paditësit bazuar në Ligjet e Punës që kanë qenë në fuqi deri më datë 16 dhjetor 2010, siç janë Ligji për Marrëdhënien e Punës i KSAK të Kosovës i vitit 1989 dhe Ligji i Punës i ish Jugosllavisë i vitit 1977, gjykata nuk e pranoi. Kjo për faktin se siç e cekëm edhe më lartë ndaj paditësit është zhvilluar procedura disiplinore bazuar në Ligjin e Policisë, Ligjin për Inspektoriatin Policor, Kodin e Etikës së Policisë dhe Udhëzimin Administrativ nr. 15/2008, që në rastin konkret janë ligje të veçanta që rregullojnë veprimtarinë, organizimin dhe funksionimin e policisë si strukturë e veçantë shtetërore. Në rastin e paditësit këto ligje e kanë rregulluar procedurën disiplinore, masat disiplinore dhe mjetet juridike të brendshme në rastet kur fillohet procedura disiplinore dhe nuk kanë lënë zbraztura juridike, që do të mund të kishin për pasojë zbatimin e dispozitave ligjore të cekura nga paditësi (Ligjet e vjetra të Punës). Si rezultat i kësaj edhe thirrja e palës paditëse në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.151/2013, datë 05.06.2013 dhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës K1186/13, datë 10.02.2014, është e pavend, pasi që siç e cekëm më lartë kemi të bëjmë me rast tjetër nga ajo që është vendosur me këto aktgjykime të përmendura më lartë dhe me organ (Policia e Kosovës) veprimtaria e së cilës, përfshirë këtu edhe marrëdhënia e punës dhe procedura disiplinore janë rregulluar me ligje të veçanta, gjë që nuk ka pasur hapësirë ligjore që eventualisht të zbatohen dispozitat e ligjeve të përmendura nga pala paditëse (Ligjet e vjetra të punës janë zbatuar vetëm në rast se Ligji Themelor i Punës-Rregullorja 2001/27, nuk e ka mbuluar ndonjë fushë nga lëmia e punës).

Nga të lartcekurat, gjykata erdhi në përfundim se në rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës paditësit A. B. nga Prizreni, vendimet e të paditurës kanë qenë të drejta dhe të bazuara në ligj, andaj edhe kërkesëpadia e tij u desh të refuzohet si e pabazuar.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së, pasi që pala e paditur në shqyrtimin kryesor deklaroi se nuk i kërkon të njëjtat.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 7, 8, lidhur me nenin 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN**  
**C.nr.1102/13, datë 05.03.2014**

**Procesmbajtësja,**  
Raxhije Emini

**Gjyqtari,**  
**Lumni Sallauka**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.